

## THIRRJE PËR DORËZIM TË OFERTAVE

Agjencioni i Mbikqyrjes së Sigurimeve ka nevojë për shërbime arsimore nga edukatorë, me qëllim të kryerjes së trajnimit dhe provimit profesional për kryerjen e aktiviteteve të avokimit të sigurimeve si dhe për kryerjen e trajnimit dhe provimit profesional për kryerjen e veprimtarisë së sigurimeve dhe brokerimit, në vitin 2018.

Për këtë qëllim, Agjencioni i Mbikqyrjes së Sigurimeve realizon një procedurë për:

- dhënien e një kontrate për prokurim publik të shërbimeve arsimore – realizim të trajnimit dhe provimit profesional për kryerjen e veprimtarive të avokimit të sigurimeve, dhe
- dhënien e një kontrate për prokurim publik të shërbimeve arsimore – realizim të trajnimit dhe provimit profesional për kryerjen e aktiviteteve të brokerimit të sigurimeve,

në përputhje me nenin 17 paragrafi (1) alineja 2 dhe paragrafi (3) i Ligjit për Prokurim Publik.

Një edukator mund të aplikojë për dy lëndë (module) për realizimin e trajnimit dhe provimit profesional për kryerjen e aktiviteteve të avokimit të sigurimeve, gjegjësisht. më së shumti për dy lëndë (module) për realizimin e trajnimit dhe provimit profesional për kryerjen e aktiviteteve të brokerimit të sigurimeve.

### I. LËNDA E PROKURIMIT PUBLIK

**1. Objekt i kontratës për prokurim publik të shërbimeve arsimore – realizim të trajnimit dhe provimit profesional për kryerjen e veprimtarive të avokimit të sigurimeve përfshin:**

**1.1 Realizim të trajnimit për kryerjen e aktiviteteve të avokimit të sigurimeve** – edukatori është i obliguar të mbajë ligjërata për një modul të caktuar në kohëzgjatje prej 3 orë mësimi, konform Programit arsimor për dhënien e provimit profesional për kryerjen e aktiviteteve të avokimit të sigurimeve i cili përfshin 6 fusha - module në vijim:

Moduli 1: Bazat e menaxhimit të riskut dhe sigurimit

Moduli 2: Legjislacioni në fushën e sigurimeve

Moduli 3: E Drejta Tregtare dhe e Detyrimeve

Moduli 4: Avokimi i Sigurimeve dhe Kodi i Etikës

Moduli 5: Sigurimi i Jetës

Moduli 6: Sigurimi i jo-jetës

- **Programi arsimor**

<http://aso.mk/dokumenti/lspiti/obuki/PROGRAMA%20zastapnici%203.pdf>

- **Doracak për dhënien e provimit profesional për avokues të sigurimeve**

<http://aso.mk/dokumenti/lspiti/Priracnik%20za%20zastapnicii%20vo%20osiguruvanjeta.pdf>

**1.2 Realizim të provimit profesional për kryerjen e aktiviteteve të avokimit të sigurimeve** - edukatori është i obliguar të përgatisë së paku 30 pyetje dhe përgjigje të reja për çdo sesion të edukimit dhe provimit, dhe 5 shembuj të rinj praktik dhe pyetje që dalin nga shembujt praktik dhe përgjigjet e tyre dhe të njëjtat t'i regjistrojë në sistemin unik elektronik për dhënien e provimit profesional për kryerjen e aktiviteteve të avokimit të sigurimit për modulën përkatës.

**2. Objekt i prokurimit publik për shërbime arsimore – realizim të trajnimit dhe provimit profesional për kryerjen e aktiviteteve të brokerimit të sigurimeve, përfshin:**

**2.1. Realizim të trajnimit për kryerjen e aktiviteteve të brokerimit të sigurimeve** - edukatori është i obliguar të mbajë ligjërata për një modul të caktuar në kohëzgjatje prej 3 orë mësimi, konform Programit arsimor për dhënien e provimit profesional për kryerjen e aktiviteteve të brokerimit të sigurimeve i cili përfshin 9 fusha - module në vijim:

Moduli 1: Bazat e menaxhimit të riskut dhe sigurimit

Moduli 2: Legjislacioni në fushën e sigurimit

Moduli 3: E Drejta Tregtare dhe e Detyrimeve

Moduli 4: Ndërmjetësimi dhe Kodi i Etikës

Moduli 5: Sigurimi i Jetës

Moduli 6: Sigurimi i jo-jetës

Moduli 7: Aspektet financiare të punës

Moduli 8: Regjistrimi i rreziqeve dhe ndërmjetësimi gjatë realizimit të dëmit

Moduli 9: Risigurimi

- **Programi arsimor**

<http://aso.mk/dokumenti/lspiti/obuki/PROGRAMA%20brokeri.pdf>

- **Doracak për dhënien e provimit profesional për kryerjen e aktiviteteve të brokerimit të sigurimeve**  
[http://aso.mk/dokumenti/lspiti/Priracnik%20za%20brokeri\\_izmeni\\_2\\_izdanie\\_lectorirano\\_finalno.pdf](http://aso.mk/dokumenti/lspiti/Priracnik%20za%20brokeri_izmeni_2_izdanie_lectorirano_finalno.pdf)

**2.2. Realizim të provimit profesional për kryerjen e aktiviteteve të brokerimit të sigurimeve** - edukatori është i obliguar të përgatisë së paku 30 pyetje dhe përgjigje të reja për çdo sesion të edukimit dhe provimit, si dhe 5 shembuj të rinj praktik dhe pyetje që dalin nga shembujt praktik dhe përgjigjet e tyre dhe të njëjtat t'i regjistrojë në sistemin unik elektronik për dhënien e provimit profesional për kryerjen e aktiviteteve të brokerimit të sigurimeve për modulën përkatës.

## II. KUSHTET DHE KRITERET PËR ZGJEDHJEN E EDUKATORËVE

Edukatori i cili do të angazhohet në realizimin e trajnimit dhe provimit profesional për kryerjen e përfaqësimit të sigurimit gjegjësisht të realizojë trajnim për kryerjen e aktiviteteve të brokerimit të sigurimit konform Ligjit për Mbikqyrjen e Sigurimeve mund të jetë personi që plotëson kushtet e mëposhtme:

1. të ketë diplomë universitare
2. të ketë përvojë pune prej 10 viteve nga fusha përkatëse për të cilën do të ligjërojë.

Si dëshmi për përmbushjen e kushteve, edukatorët duhet të dorzojnë:

1. Diplomë ose Çertifikatë për kryerjen e arsimit të lartë, të nivelit VII/1 të përgatitjes profesionale apo 240 ECTS;
2. Vërtetim për përvojë pune prej 10 viteve nga fusha përkatëse për të cilën edukatori do të mbajë ligjërata të lëshuar nga personi juridik (punëdhënësi) ku personi ka fituar përvojën e punës, duke specifikuar detyrat e punës që ka kryer dhe periudhën e angazhimit të tij tek personi juridik;

Nëse në procedurën e përzgjedhjes së edukatorëve për realizimin e trajnimit dhe provimit profesional për kryerjen e aktiviteteve të avokimit të sigurimeve, gjegjësisht trajnimit dhe provimit profesional të aktiviteteve të brokerimit të sigurimeve paraqiten më shumë persona të cilët i plotësojnë kushtet konform Ligjit për Mbikqyrjen e Sigurimeve, përzgjedhja e edukatorëve do të bëhet sipas rangimit (pikëve) të personave të paraqitur sipas kriterëve të mëposhtme me pika të përcaktuara për secilin kriter veçmas:

|   |    |
|---|----|
| Përvoja e punës në fushën përkatëse (për çdo vit, mbi 10 vite)  | 1  |
| Përvojë pune nga lënda përkatëse (moduli) dhe/ose lëndë të ngjajshme (modul) të Programit arsimor për të cilën personi aplikon të realizojë trajnimin | 5  |
| Titull shkencor nga fusha përkatëse   | 50 |
| Doktoratë nga fusha përkatëse   | 30 |
| Doktoratë   | 25 |
| Diplomë Master nga fusha përkatëse  | 15 |
| Diplomë Master  | 10 |
| Libër të publikuar nga fusha përkatëse  | 10 |
| Monografi e publikuar nga fusha përkatëse   | 6  |
| Hulumtim të publikuar nga fusha përkatëse në një revistë shkencore me impakt faktor   | 8  |
| Hulumtim të publikuar nga fusha përkatëse në një revistë shkencore pa impakt faktor   | 4  |
| Pjesëmarrja në një konferencë ndërkombëtare me një hulumtim të publikuar  | 4  |
| Pjesëmarrja në një konferencë vendore me një hulumtim të publikuar  | 3  |
| Doracak të publikuar ose materiale tjera të punës nga fusha përkatëse   | 4  |
| Libër vjetor të publikuar apo antologji nga fusha përkatëse   | 3  |
| Artikuj të publikuar në revista vendore dhe ndërkombëtare nga fusha përkatëse   | 2  |

Si dëshmi për përmbushjen e kriterëve të përcaktuara, edukatori duhet të paraqesë dokumentet e duhura (dëshmi) për titullin e fituar shkencor arsimor, nivel të kryer arsimor më të lartë, libra të botuara, monografi, hulumtime/punime, doracak.

Për edukatorë, do të përzgjidhet personi i cili pas rangimit (pikëve) sipas kriterëve të përcaktuara do të ketë numër më të madh të pikëve.

### **III. PAGESA E EDUKATORËVE**

Pagesa e edukatorëve të angazhuar për realizimin e trajnimeve për dhënien e provimit profesional për kryerjen e aktiviteteve të avokimit të sigurimit përcaktohet në lartësi prej 3.000 denarëve - neto për një orë mësimi (45 minuta) trajnim të realizuar (ligjëratë) nga Programi arsimor për dhënien e provimit profesional për kryerjen e aktiviteteve të avokimit të sigurimit.

Pagesa për një pyetje të përgatitur dhe përgjigjet e saj, një shembull praktik të përgatitur dhe një pyetje që del nga shembulli praktik dhe përgjigjet e saj për provimin profesional për kryerjen e aktiviteteve të avokimit të sigurimeve dhe regjistrimin e tyre në sistemin unik elektronik për dhënien e provimit profesional për kryerjen e aktiviteteve të avokimit të sigurimeve përcaktohet në lartësi prej 85 denarëve - neto.

Pagesa e edukatorëve të angazhuar për realizimin e trajnimit për dhënien e provimit profesional për kryerjen e aktiviteteve të brokerimit të sigurimit përcaktohet në lartësi prej 3.000 denarëve - neto për një orë mësimi (45 minuta) trajnim të realizuar (ligjëratë) nga Programi arsimor për dhënien e provimit profesional për kryerjen e aktiviteteve të brokerimit të sigurimeve.

Pagesa për një pyetje të përgatitur dhe përgjigjet e saj, një shembull praktik të përgatitur dhe një pyetje që del nga shembulli praktik dhe përgjigjet e saj për provimin profesional për kryerjen e aktiviteteve të brokerimit të sigurimeve dhe regjistrimin e tyre në sistemin unik elektronik për dhënien e provimit profesional për kryerjen e aktiviteteve të brokerimit të sigurimit përcaktohet në lartësi prej 85 denarëve - neto.

### **IV. AFATI I FUNDIT DHE VENDI I DORËZIMIT TË OFERTAVE**

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është 15.2.2018 deri në orën 16:30.

Në ofertë duhet të potencohet qartë:

- a. për cilin trajnim dhe provim profesional aplikon ofertuesi; dhe
- b. për cilën lëndë (modul) aplikon ofertuesi.

Ofertat së bashku me dëshmitë për plotësimin e kushteve konform Ligjit për Mbikqyrjen e Sigurimit, si dhe dëshmitë për plotësimin e kriterëve të përcaktuara duhet të dorëzohen në adresën e mëposhtme:

Agjencioni i Mbikqyrjes së Sigurimeve

rr. Makedonija pn - Pallati Lazar Pop-Trajkov kati 5, 1000 Shkup.

personi për kontakt Armin Ukiq [amin.ukikj@aso.mk](mailto:amin.ukikj@aso.mk)

Agjencioni i Mbikqyrjes së Sigurimeve